



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
DREJTORIA E KONFORMITETIT, AKT-EKSPERTIZAVE DHE PROJEKTEVE

SEKTORI I KONFORMITETIT DHE AKT- EKSPERTIZAVE

Ky sektor përbëhet nga një Përgjegjës dhe 5 specialistë



Përgjegjës sektori- Gramos Dushku

Ka përfunduar arsimin e lartë në Universitetin Politeknik të Tiranës në Degën Inxhinieri Mekanike Logjistikë dhe Prodhim.

Që prej datës 20.10.2014 është shef i Sektorit të Konformitetit dhe akt-ekspertizave.

Objekti i punës së Sektorit të Konformitetit dhe akt-ekspertizave është:

- Inspektimi i fabrikave që prodhojnë produkte ndërtimi për të vlerësuar cilësinë e produkteve
- Vlerësimi i konformitetit në fushën e prodhimit të produkteve të ndërtimit, në përputhje me standardet në fuqi
- Kryerja e Akt- ekspertizave

Sektori bashkëpunon ngushtë dhe shkëmben informacione me Ministrinë e Linjës (Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë), Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK), dhe Organizma apo Shoqëri të tjera të cilat kanë lidhje me detyrat e sektorit.

Sektori përbëhet nga dy zyra:

- Zyra e Inspektimit
- Zyra e Vlerësimit të Konformitetit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
DREJTORIA E KONFORMITETIT, AKT-EKSPERTIZAVE DHE PROJEKTEVE

Aktiviteti i Zyrës së Inspektimit është:

- Kryerja e asistencës tekniko-ligjore për vendosjen e sistemit të kontrollit të prodhimit në fabrikë
- Identifikimi dhe azhornimi i subjekteve prodhuese e shpërndarëse të produkteve të ndërtimit
- Evidentimi i problematikës teknike në zbatim të standardeve në fuqi për produktet e ndërtimit
- Ndihma për prodhuesit në përdorimin e standardeve bashkëkohore me qëllim përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së produkteve të ndërtimit
- Marrja e mostrave për testim në laboratorët e Institutit të Ndërtimit

Aktiviteti i Zyrës së Vlerësimit të Konformitetit është:

- Vlerësimi i konformitetit në fushën e prodhimit të produkteve të ndërtimit
- Konfirmimi i Kartës Teknologjike të fabrikave të prodhimit të materialeve të ndërtimit dhe vlerësimi i konsumit të lëndëve djegëse për njësi produkti të gatshëm
- Përgatitja e projekt procedurave në fushën e vlerësimit të konformitetit të produkteve të ndërtimit